

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
PARKUT ARKEOLOGJIK KOMBËTAR APOLONIA
DHE
PARKUT ARKEOLOGJIK ULPIANA

Tiranë, 2021

Në kuadër të bashkëpunimit të përbashkët, dhe duke njohur më tej rëndësinë e zonave si vende të trashëgimisë kombëtare, Parku Arkeologjik Kombëtar Apolonia dhe Parkut Arkeologjik Ulpiana (*këtu e tutje bashkërisht të referuara si "Palët"*)

Ky Marrëveshje Bashkëpunimi synon të mbështesë marrëdhëniet kulturore midis palëve.

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 OBJEKTIVI

Objektivi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, është krijimi i një kuadri të përgjithshëm bashkëpunimi për aktivitetet, ngjarjet, takimet, kërkimet, shkëmbimit të informacionit dhe lehtësimit të dialogut në lidhje me ruajtjen dhe promovimin e parqeve që do të planifikohen e organizohen bashkërisht nga palët.

Neni 2 FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në zbatimin e aktiviteteve dhe pikave të listuara më poshtë, sipas mundësive të tyre dhe brenda burimeve të disponueshme.

- a) të promovojnë praktikat më të mira të promovimit, ruajtjes dhe konservimit përmes komunikimit dhe edukimit;
- b) të inkurajojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës për çështjet e ruajtjes, konservimit dhe menaxhimit;
- c) të nxitin zhvillimin dhe përhapjen e ndërgjegjësimit për vlerat e trashëgimisë kulturore që ofrojnë sitet/parqet
- d) të marrin pjesë reciprocisht në seminare trajnimi në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- e) të inkurajojnë pjesëmarrjen efektive të aktorëve të tjerë kryesorë, duke përfshirë qeverinë dhe organizatat joqeveritare, komunitetet, pronarët e tokave, komunitetin akademik dhe sektorin privat, në nivel lokal, kombëtar, dhe ndërkombëtar, në funksion të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit;
- f) njohjen reciproke e bashkëpunimit nëpërmjet mekanizmave të komunikimit si dhe lidhjet përmes rrejteve sociale, faqeve zyrtare të internetit;
- g) shkëmbimin e përvojës dhe kuadrit profesional-shkencor;
- h) hulumtime të përbashkëta;
- i) organizimin e ekspozitave arkeologjike;
- j) qasje në laboratorët e Parqeve me qëllim të kryerjes së analizave laboratorike.

Neni 3

KUADRI PËR ZBATIM

1. Palët bien dakort reciprocikisht të hartojnë një plan vjetor të aktiviteteve që do të ndërmarrin për çdo vit kalendarik në lidhje me aktivitetet e dakortesuara, duke specifikuar përgjegjësitë për zbatimin, buxhetin e përgjithshëm dhe përgjegjësitë financiare për të dy Palët dhe çdo partner tjetër për çdo veprimtari sipas rastit.
2. Të dyja palët pranojnë se fusha të tjera të bashkëpunimit mund të zhvillohen, gjatë periudhës së zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me qëllim për t'u përfshirë në planet e tyre të përbashkëta dhe individuale të punës.

Neni 7

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e të dyja Palëve dhe do të jetë efektive deri në Nëntor 2025. Marrëveshja e Bashkëpunimi mund të rinovohet për periudha të njëpasnjëshme shtesë prej 5 vitesh me marrëveshjen e të dyja palëve.
2. Ky Marrëveshje hartohet në dy kopje, në gjuhën Shqipe dhe hyn në fuqi menjëherë pas firmosjes nga palët.

PËR


MINISTRINË E KULTURËS TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PARKU ARKEOLOGJIK KOMBËTAR APOLONIA



DREJTOR
ORNELA DURMISHAJ

PËR

MINISTRINË E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PARKU ARKEOLOGJIK ULPIANA



SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
BISLIME BISLIMI